

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali në tenderin e KQZ/ Si ndërhyu sekretarja në sistem për të favorizuar kompaninë e vëllait të Feri t Hoxhës
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/tenderi-43-milione-leke-i-kqz-se-komisioni-eleminoi-oferten-me-te-mir-i46763
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:32:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:14:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7ac873e7dc59d76bbd74ca5bcf4fd4b0be758138627bd43fac5cd47922f0c73b
TEKSTI	b5285a8755bb4bb7f6871d32af82b7ac8119d74230733d923ffeec9f4132e5f8
PAMJA	ea6676a64c6e10553d5b7ef48f175e98c279c0de97965a00622796b4dac00827

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b768527ccd42d80bb74a3b47215d190249e2e06e9c1ab8a362b76907009dbc56
E MËPARSHMJA	d355d5becc3771a4a53899c8e9a8474eeb64755e1d6afe0361dfd1727af026bd
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b768527ccd42d80bb74a3b47215d190249e2e06e9c1ab8a362b76907009dbc56>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Protestë masive në Prishtinë kundër vendimit të Hagës, djemtë e liderëve të UÇK: Nuk dorëzohemi, politikanët të bëhen bashkë](#)

18 Shtator 2026, 13:00

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 18 Shtator 2026, 16:14

Skandali në tenderin e KQZ/ Si ndërhyu sekretarja në sistem për të favorizuar kompaninë e vëllait të Ferit Hoxhës

Sipas udhëzimit të APP-së, nëse provat nuk paraqiten, kërkesa për penalizimin e operatorit do të konsiderohet e paparaqitur





Një tender i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me fond limit rreth 43 milionë lekë për mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike ka ngritur pikëpyetje mbi mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe skualifikimin e njërit prej operatorëve pjesëmarrës.

Procedura me objekt "Mirëmbajtja e moduleve ekzistuese të KQZ-së" kishte një fond limit prej 42.9 milionë lekësh pa TVSH.

Në garë morën pjesë disa operatorë ekonomikë. Sipas të dhënave të procedurës, "EVOLVE WEB STUDIO" paraqiti ofertë prej rreth 33 milionë lekësh, ndërsa "INSTANT.AL" ofertë rreth 33.7 milionë lekë. Nga ana tjetër, bashkimi i operatorëve "INTELISOFT & WOW DIGITAL" paraqiti ofertë prej rreth 40.8 milionë lekësh.

Megjithatë, rezultati i garës u përcaktua jo vetëm nga oferta ekonomike, por edhe nga pikëzimi i kriterëve teknike.

Sipas pretendimeve të ngritura lidhur me procedurën, gjatë fazës së rivlerësimit dy operatorët me ofertat më të ulëta janë vlerësuar me zero pikë në kriteret teknike, ndërsa ofertës së bashkimit "INTELISOFT & WOW DIGITAL" i janë dhënë pikët maksimale.



☐ ☐ ☐ |

Tiranë më 30.12.2025

Nr. 3752/___

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Data: 30.12.2025

Drejtuar: BOE "INTELISOFT" sh.p.k me NIPT L91702001P me 30%

Adresa: Rr.233, Ap nr 3, Numri iPasurisë 4/9+1-N3, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.

"WOW DIGITAL" sh.p.k me NIPT M01406022R me 70%

Adresa: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Tiranë.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐
JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

Tipi i Kontratës: Sherbime.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedure e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, elektronike.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-52084-06-23-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mirëmbajtja e moduleve ekzistuese të KQZ-së.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 24.06.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 33 datë 30 Qershor 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Pikëpyetje janë ngritur edhe mbi mënyrën e administrimit të procesit në sistemin elektronik. Ndërsa Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përbëhej nga Daniela Alimemeti, Redion Lila dhe Fatjona Sulaj, në dokumentacionin e shqyrtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik rezultoi se përdoruesi "Jonakz Josifi" në sistemin gjatë fazës së rivlerësimit.

Një tjetër element i procedurës lidhet me kualifikimin e shoqërisë "INSTANT.AL".

KQZ pretendoi se kompania kishte paraqitur dokumente me të dhëna të rreme për ekspertin Granit Gjana, konkretisht diploma dhe certifikata, dhe mbi këtë bazë i kërkoi Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e procedurës për përjashtimin e operatorit nga e drejta për të marrë pjesë në kontrata publike.

Por APP nuk e ka pranuar në këtë fazë kërkesën për penalizimin e kompanisë.

Në shkresën e Drejtorisë Juridike të APP-së thuhet se nga verifikimet e kryera, certifikatat dhe diploma e paraqitura nga "INSTANT.AL", si dhe kodet QR që përmbanin këto dokumente, rezultojnë në emër të Granit Gjanes.

Për këtë arsye, APP i ka kërkuar KQZ-së të kryejë verifikime të drejtpërdrejta dhe të dokumentuara pranë kompanisë lëshuese "Alison", me qëllim që të përcaktohet nëse certifikatat dhe diploma janë lëshuar apo jo prej saj. Sipas udhëzimit të APP-së, vetëm nëse verifikimi zyrtar konstaton se dokumentet janë të falsifikuara, KQZ duhet t'i përcjellë provat pranë APP-së. Në të kundërt, nëse provat nuk paraqiten, kërkesa për penalizimin e operatorit do të konsiderohet e paparaqitur.



Nr. 2101 Prot.
Datë, më 17.9.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK DREJTORIA JURIDIKE DHE E PROFESIONALIZIMIT

Nr. 5871/3 Prot.

Tiranë, më 18.08.2026

Lënda: Kërkesë.

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë

Në vijim të komunikimit me autoritetin tuaj kontraktor, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") mori në shqyrtim shkresën tuaj Nr. 1873/2 Prot., datë 19.08.2026 (protokolluar në institucion me Nr. 5871/2 Prot., datë 20.08.2026) me objekt: "Kthim përgjigje".

Sikurse jeni në dijeni, APP me shkresën Nr. 5871/1 Prot., datë 13.08.2026 ka kërkuar nga autoriteti juaj kontraktor të qartësojë mospërputhjet e konstatuara në informacionin e dërguar në procesverbalin Nr. 48/15 Prot., datë 29.07.2026, mbi arsyet e skualifikimit të shoqërisë "Instant.AL" Shpk, sa i takon dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator ekonomik në emër të Z. Granit Gjana në procedurën e prokurimit me objekt: "Mirëmbajtja e moduleve ekzistuese të KQZ-së", të cilat janë depozituar në APP, si të dhëna të rreme.

Nga shqyrtimi i shkresës së dërguar, konstatohet se, keni cituar se, vlerësimi i KVO është mbështetur në gjendjen faktike dhe dokumentare të verifikueshme gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit provues, të fiksuar në kohë reale dhe të administruar në procesverbalin e përcjellë me shkresën tonë paraardhëse përpara përfundimit të vlerësimit dhe njoftimit të operatorit ekonomik.

Ndërkohë, sikurse ju kemi bërë me dije, nga verifikimet e kryera nga APP, sa i takon certifikatave dhe Diplomës së Granit Gjanes...

verifikimet dhe Liplonies se paraqitur nga operatori ekonomik "Instant.AI" Shpk, në adresat e cituara nga ana juaj në procesverbal, si dhe skanimit të kodit QR që përmbanin këto dokumenta, rezultojnë në emër të Z. Granit Gjana. Pra, verifikimet nga APP, janë kryer mbi dokumentacionin e sipërcituar, i cili është dërguar nga ana juaj në cilësinë e provës.

Sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP, procedimi administrativ për përjashtimin e një operatori ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, fillon nëse ngrihen pretendime mbi vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit, si pjesë e ofertës së tij në një

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 1/2

Në këtë mënyrë, procedura për "INSTANT.AL" mbetet ende e hapur dhe nuk ka një vendim përfundimtar të APP-së që ta përjashtojë kompaninë nga kontratat publike. Në anën tjetër, në garë është edhe "INTELISOFT", kompani e lidhur me biznesmenin Gëzim Hoxha. Hoxha është vëllai i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, si dhe pronar i kompanisë "FIRST", e cila përmendet në shumë fashikuj të dosjes së AKSHI-t si një nga përfitueset kryesore të tenderëve publikë. Të dhënat e hetimit zbulojnë se ai ka përfituar dhjetëra miliona euro nga arka e shtetit, ku vetëm në një rast ka deklaruar përfitimin e rreth 60 milionë eurove nga AKSHI, para që më pas janë transferuar te subjekte të lidhura, përfshirë bashkëpunëtorë si Ermal Beqiri. Emri i Gëzim Hoxhës shfaqet po ashtu në aferën e "Durana Tech Park", ku një grup kompanish të lidhura dyshohet se ndërtuan një skemë për transferimin e aktivitetit në parqe teknologjike me qëllim shmangien e taksave përmes subjekteve të reja, por me të njëjtët përfitues realë.

Tenderi i KQZ-së tashmë ngre disa çështje që kërkojnë sqarim: mënyra e pikëzimit teknik, përdoruesit që kanë pasur akses në sistem gjatë rivlerësimit, arsyetimi i skualifikimit të operatorëve me ofertat më të ulëta dhe, në mënyrë të veçantë, verifikimi zyrtar i dokumenteve mbi të cilat u mbështet një prej skualifikimeve.

Deri në përfundimin e verifikimeve të kërkuara nga APP, pretendimi për përdorimin e dokumenteve të rreme nga "INSTANT.AL" nuk mund të konsiderohet i provuar./vna

Poll



AKTUALITET

[EMRAT/ Tentativë vrasje dhe trafik droge, arrestohen në Itali dy shqiptarë të kërkuar nga drejtësia](#)

18 Shtator 2026, 16:56

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Kardinalit shqiptar i vjedhin 30 mijë euro në shtëpinë në Firenze, ja si reagoi 97-vjeçari Ernest Simoni](#)

18 Shtator 2026, 16:45

^ekstrakti^





AKTUALITET

[Zhduku 950 mijë euro verëra nga vila e Ergys Agasit, lihet në burg Eno Agasi. Çështja i kalon SPAK](#)

18 Shtator 2026, 16:41

^ekstrakti^

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.